

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I

SHOQËRISË AKSIONARE ME OFERTË PRIVATE

“ASIGEST BROKER ALBANIA” SH.A.



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË AKSIONARE ME OFERTË PRIVATE
“ASIGEST BROKER ALBANIA” SH.A.**

Në këtë dokument, nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

“Ligji nr. 9901/2008”	Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
“Statuti”	Ky akt themelimi dhe statut i shoqërisë aksionare me ofertë private “ASIGEST BROKER ALBANIA” Sh.a;
“Shoqëria”	Shoqëria aksionare me ofertë private “ASIGEST BROKER ALBANIA” Sh.a;
“Aksionar”	Personat fizikë ose juridikë që zotërojnë aksionet e Shoqërisë në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të këtij Statuti;
“Vendim i Zakonshëm”:	Vendimi i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të Aksionarëve pjesëmarrës sipas kërkesave të nenit 145 (2) të Ligjit nr. 9901/2008;
“Vendim i Jashtëzakonshëm”:	Vendimi i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me tre të katërtat e votave të Aksionarëve pjesëmarrës në votim, sipas kërkesave të nenit 145 (1) të Ligjit nr. 9901/2008;
“Ligji për QKB-në”:	Ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar;
“QKB”:	Qendra Kombëtare e Biznesit;
“Ligji për Sigurimet”:	Ligji nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria iu drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt nëse u dërgohen Aksionarëve në adresat e regjistruara në Regjistrin e Aksioneve të Shoqërisë sipas nenit 11 të këtij Statuti, në bazë të deklarimeve që Aksionarët i bëjnë administratorit të Shoqërisë.

Të gjitha njoftimet, kërkesat, ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti, do të konsiderohen të kryera rregullisht nëse: **(i)** janë dorëzuar dorazi, **(ii)** janë dërguar me postë rekomande me kthim përgjigje, **(iii)** janë dërguar me korrier ekspres, ose **(iv)** janë dërguar me postë elektronike në adresën e komunikuar nga Aksionari.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria iu drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti, do të konsiderohen të marra në mënyrë të rregullt nga Aksionari në datën më të hershme, ndërmjet: **(i)** datës së marrjes efektive ose refuzimit të pranimin nga ana e Aksionarit marrës ose **(ii)** datës së njoftimit të kthimit nga shërbimi postar, ose **(iii)** datës së dërgimit të komunikimit në rrugë elektronike.

KREU I
Themelimi, Emri, Qëllimi, Kohëzgjatja, Selia

NENI 1
Themelimi

(1) Sot me datë 08/11/2018, themelohet kjo shoqëri aksionare me ofertë private me emrin "ASIGEST BROKER ALBANIA" SHA, nga personat si më poshtë, në cilësinë e Aksionarëve Themelues:

1. Shoqëria "GENERATE" Shpk, NUIS L61529028E, me seli në Tiranë, Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Brigada VIII, Pallati Nr. 28, Kati 3, e përfaqësuar nga administratori Z. Andi Canaj, i identifikuar me letërnjoftimin nr. 032759552, me nr. personal I10128046V;
2. Z. Alessandro Griffith Brookles, shtetas italian, lindur në Bergamo (Itali), më 26.06.1960, mbajtës i pasaportës të lëshuar nga Republika e Italisë me nr. YA4282090;
3. Z. Pietro Urso, shtetas italian, lindur në Catania (Itali), më 22.01.1981, mbajtës i pasaportës të lëshuar nga Republika e Italisë me nr. YA6853407;
4. Z. Enid Mero, shtetas shqiptar, vendlindja Korçë, i datëlindjes 08.03.1991, i identifikuar me pasaportën nr. BD8240660, me nr. personal J10308083B.

NENI 2
Objekti i Shoqërisë

(1) Objekti i Shoqërisë do të jetë kryerja e aktivitetit të ndërmjetësimit (*broker*) në fushën e sigurimit të jetës, jo-jetës dhe risigurime, sipas përcaktimeve të Ligjit për Sigurimet dhe pas pajisjes me licencën përkatëse nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër plotësuese, të lidhur, ndihmëse apo të dobishme për realizimin e objektit të saj të lejuar nga Ligji për Sigurimet dhe legjislacioni në fuqi.

NENI 3
Kohëzgjatja

(1) Shoqëria themelohet për të ushtruar aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

NENI 4
Selia, Website dhe adresa elektronike

- (1) Shoqëria do të ketë selinë e saj në adresën: Tiranë, Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Dervish Bej Mitrovica, pallati Kristi - Co, nr.6, kati përdhe, nr. 1.
- (2) Shoqëria do të ketë *website-in* e saj zyrtar dhe adresën e saj zyrtare për komunikimet elektronike, të cilat njoftohen vullnetarisht në QKB.

KREU II
Kapitali i Regjistruar, Kontributet, Aksionet, Aksionarët

NENI 5
Kapitali i Regjistruar, Themeluesit

- (1) Kapitali i regjistruar i Shoqërisë, është 3.500.000,00 (tre milion e pesëqind mijë) Lekë, i cili ndahet në 350 (treqind e pesëdhjetë) aksione të zakonshme, me vlerë nominale 10.000 (dhjetëmijë) Lekë secila.
- (2) Aksionet e Shoqërisë nënshkruhen e paguhen në para nga Themeluesit, siç përcaktohet në Shtojcën I bashkëngjitur këtij Statuti si pjesë përbërëse e tij.
- (3) Kostot e themelimit deri në vlerën 500.000 Lekë do t'iu rimbursohen themeluesve të Shoqërisë nga fitimet që do të realizojë Shoqëria dhe ky rimbursim do të ketë përparësi gjatë shpërndarjes së fitimeve.

NENI 6
Aksionet, Aksionarët

- (1) Aksionarët e Shoqërisë do të jenë personat të cilët kanë fituar aksionet në mënyrat e përcaktuara nga ligji dhe dispozitat e këtij Statuti.
- (2) Aksionet e Shoqërisë mund të jenë të kategorive të ndryshme, sipas vendimmarrjes së Asamblesë së Përgjithshme (aksione të zakonshme, aksione me përparësi, aksione me ose pa të drejtë vote). Aksionet që japin të njëjtat të drejta përbëjnë aksione të së njëjtës kategori. Të drejtat e përparësisë që burojnë nga aksionet me përparësi vendosen nga Asambleja e Përgjithshme me të njëjtën shumicë të kërkuar nga ligji për ndryshimin e statutit. Të drejtat e përparësisë të shënuara në Statut do të konsiderohen shteruese. Çdo aksion do të ketë të njëjtën vlerë nominale. Kriteret e vlerësimit dhe procedurat për shndërrimin e aksioneve nga njëra klasë në tjetrën, si dhe për shndërrimin e obligacioneve e titujve të tjerë, vendosen nga Asambleja e Përgjithshme me të njëjtën shumicë të kërkuar nga ligji për ndryshimin e Statutit.
- (3) Aksionet nënshkruhen nga Aksionarët brenda 20 ditëve nga data e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit me emetim të aksioneve të reja. Për shlyerjen e Aksioneve do të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 9901/2008. Aksionarët kanë të drejtën e parablerjes për Aksionet e emetuara rishtazi, në përpjesëtim me pjesën e kapitalit të regjistruar që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej tyre. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet brenda 20 ditëve pas publikimit të parashikuar në nenin 169 të Ligjit nr. 9901/2008.

KREU III
NDRYSHIME TË KAPITALIT – NDRYSHIME TË AKSIONEVE – REGJISTRI I
AKSIONEVE

NENI 7
Zmadhimi i Kapitalit dhe e drejta e parablerjes

- (1) Asambleja e Përgjithshme, nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm, mund të zmadhojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9901/2008.
- (2) Aksionarët kanë të drejtën e parablerjes për Aksionet e emetuara rishtazi, në përpjesëtim me pjesën e kapitalit të regjistruar që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej tyre. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet brenda 20 ditëve pas publikimit të parashikuar në nenin 169 të Ligjit nr. 9901/2008.
- (3) Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin në përputhje me mënyrat, kushtet dhe procedurat e parashikuara nga Ligji nr. 9901/2008.

NENI 8
Zvogëlimi i Kapitalit

- (1) Asambleja e Përgjithshme, nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm, mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
- (2) Në rastet kur zvogëlimi i kapitalit nuk kryhet për shkak të humbjeve të aktivitetit tregtar, Asambleja e Përgjithshme, nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm, mund të vendosë të anulojë një ose më shumë aksione në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901/2008.

(3) Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin në përputhje me mënyrat, kushtet dhe procedurat e parashikuara nga Ligji nr. 9901/2008.

NENI 9

Regjistri i Aksioneve

(1) Administratori i Shoqërisë harton një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat përcaktuara sipas Ligjit nr. 9901/2008 në lidhje me të gjitha aksionet e Shoqërisë. Administratori, sipas rastit, hedh të dhënat e aksioneve të emetuara rishtazi apo regjistron anulimin e aksioneve. Administratori regjistron gjithashtu në këtë regjistër kalimin aksioneve që i njoftohet nga Aksionari që e kalon aksionin, si dhe çdo veprim dhe e dhënë tjetër në lidhje me aksionet që mund të kërkohet me ligj apo sipas vendimeve të Shoqërisë.

(2) Personat e regjistruar në regjistrin e aksioneve prezumohen Aksionarë të Shoqërisë me të drejta të plota ndaj Shoqërisë dhe të tretëve. Aksionet dhe të drejtat e fituara mbi to nuk mund të ushtrohen përpara se veprimi të jetë regjistruar në Regjistrin e Aksioneve që mban Shoqëria.

(3) Në përputhje me afatet ligjore, Administratori njofton të dhënat e regjistrimit të aksioneve të Shoqërisë.

(4) Çdo Aksionar mund t'i kërkojë Shoqërisë lëshimin e një vërtetimi mbi të dhënat e tij të regjistrimit në regjistrin e aksioneve të Shoqërisë. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mund të lëshojë certifikata për vërtetimin e zotërimit të aksionit.

(5) Asambleja e Përgjithshme miraton ose i delegon Administratorit kompetencën për të miratuar rregullore të posaçme mbi formatin e regjistrimit të aksioneve dhe procedurat për kryerjen e regjistrimeve.

KREU IV

Organet e Shoqërisë

NENI 10

Asambleja e Përgjithshme

(1) Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë, i cili ka të drejtat e detyrimit e përcaktuara sipas nenit 135 të Ligjit nr. 9901/2008.

(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, të përcaktuar në njoftimin e thirrjes. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të zhvillohet edhe nëpërmjet telekonferencës, videokonferencës ose mjete të tjera elektronike nëse të gjithë pjesëmarrësit janë identifikuar dhe u është dhënë mundësia të ndjekin diskutimin, të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe të votojnë. Asambleja e Përgjithshme zgjedh mes të pranishmëve Kryetarin dhe Sekretarin e mbledhjes. Nëse plotësohen kushtet e mësipërme, Asambleja konsiderohet e mbledhur në vendin ku ndodhen Kryetari dhe Sekretari i Mbledhjes, në mënyrë që të mund të hartohen dhe nënshkruhen procesverbalet në librin përkatës të Shoqërisë.

(3) Për thirrjen, punimet, kuorumin, vendimet, të drejtat e pjesëmarrjes, të përfaqësimit, të votës, si dhe për çdo çështje tjetër në lidhje me Asamblesë së Përgjithshme që nuk është rregulluar shprehimisht në këtë Statut, zbatohen dispozitat e neneve nga 135 deri në 153 të Ligjit nr. 9901/2008.

(4) Asambleja e Përgjithshme miraton rregullore të brendshme mbi funksionimin dhe veprimtarinë e saj.

NENI 11

Këshilli i Administrimit

(1) Shoqëria do të ketë një Këshill Administrimi të përbërë nga 3 (tre) anëtarë.

(2) Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërohen nga Asambleja e Përgjithshme, nëpërmjet një Vendimi të Zakonshëm, me një afat jo me të gjatë se 3 vjet, me të drejtë riemërimi. Këshilli i Administrimit, me shumicë votash të gjithë anëtarëve të tij, emëron ndërmjet anëtarëve të tij Kryetarin dhe Zv. Kryetarin të cilët do të kryesojnë mbledhjet e Këshillit të Administrimit. Emërimi ka pasoja ligjore pas miratimit nga Shoqëria dhe regjistrimit në QKB. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë rregulla në lidhje me emërimin e tyre.

- (3) Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në çdo kohë anëtarët e Këshillit të Administrimit, me anë të një Vendimi të Zakonshëm.
- (4) Anëtarët e Këshillit të Administrimit janë individë, shumica e të cilëve është e pavarur dhe e ndryshme nga administratorët e Shoqërisë.
- (5) Këshillit i Administrimit ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e parashikuara në nenet 154 e vijues të Ligjit n. 9901/2008. Këshillit i Administrimit mund të miratojë rregullore të brendshme mbi funksionimin e veprimtarinë e tij.
- (6) Mënyra e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit përcaktohet nga Asambleja e Aksionarëve.
- (7) Për thirrjen, punimet, kuorumin, vendimet, të drejtat e pjesëmarrës, të përfaqësimit, të votës, si dhe për çdo çështje tjetër në lidhje me Këshillin e Administrimit që nuk është rregulluar në këtë Statut apo në rregulloret e brendshme të Shoqërisë, zbatohen dispozitat e neneve 154 e vijues të Ligjit nr. 9901/2008.
- (8) Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit janë personat e përcaktuar në Shtojcën 2 të këtij Statuti.

NENI 12 Administratori(ët)

- (1) Këshilli i Administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të Shoqërisë, me afat emërimi deri në 3 vjet. Administratorët mund të riemërohen në detyrë. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të kryejnë detyrën e administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit janë anëtarë të pavarur, që nuk kryejnë këtë detyrë.
- (2) Administratori(ët) është/janë përfaqësuesi(t) ligjor(e) të Shoqërisë dhe ka/në të drejtë të përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët, në përputhje me të drejtat e detyrimit e përcaktuara sipas nenit 158 të Ligjit nr. 9901/2008 dhe dispozitat ligjore në fuqi.
- (3) Tagrat e përfaqësimit të Administratorit(ëve) dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë QKB-së në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901/2008.
- (4) Këshilli i Administrimit mund të shkarkojë Administratorin(ët) në çdo kohë.
- (5) Masa dhe mënyra e shpërblimit të Administratorit/ëve vendoset nga Këshilli i Administrimit.
- (6) Kompetencat e Administratorit/eve të Shoqërisë janë ato të parashikuara nga neni 158 dhe 159 i Ligjit nr. 9901/2008. Përveç këtyre kompetencave, Administratori/et kanë si kompetenca të posaçme dhe sa vijon: **(i)** marrjen e vendimeve për ekzekutimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, **(ii)** ndjekjen e udhëzimeve të Këshillit të Administrimit, **(iii)** marrjen e vendimeve në lidhje me strukturën organizative të Shoqërisë, nivelit të punësimit dhe të pagave në Shoqëri; **(iv)** përfaqësimin e Shoqërisë për kryerjen e transaksioneve të nevojshme të aktivitetit, kreditim, huamarrje dhe huadhënie dhe çdo veprim juridik deri në vlerën prej 20% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë apo që krijon një ekspozim për Shoqërinë deri në këtë vlerë. Transaksionet dhe veprimet juridike që tejkalojnë vlerën prej 20% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë apo që krijojnë një ekspozim për Shoqërinë mbi këtë vlerë do të jenë të vlefshme vetëm me nënshkrimin e Kryetarit të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë, bashkë me atë të administratorit.
- (7) Për çdo çështje tjetër në lidhje me Administratorët që nuk është rregulluar në këtë Statut apo në rregulloret e brendshme të Shoqërisë, zbatohen dispozitat përkatëse të neneve nga 154 e vijues të Ligjit nr. 9901/2008.

NENI 13 Shpërblimi

- (1) Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të përfitojnë pagë bazë dhe shpërblime shtesë, përfshirë këtu pjesë nga fitimi i Shoqërisë apo të drejta opsioni mbi Aksionet. Paga e administratorëve mund të shtohet me shpërblime shtesë. Skema e këtyre shpërblimeve përgatitet nga Këshilli i Administrimit dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 14 Auditimi

(1) Shoqëria kryhen auditimin e aktivitetit të saj tregtar dhe emërimin e auditorit(ëve) në përputhje me kërkesat ligjore.

KREU V **Të ndryshme**

NENI 15 **Dividendët**

(1) Pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit të mëparshëm financiar, nga fitimi që Shoqëria ka realizuar, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm të shpërndajë dividend në favor të Aksionarëve në përputhje me përqindjen e kapitalit që përfaqësojnë Aksionet e zotëruara prej tyre.

(2) Dividendi paguhet në një ose disa këste, duke pasur parasysh nevojat e likuiditetit të Shoqërisë.

(3) Asnjë dividend nuk mund t'u shpërndahet Aksionarëve, për sa kohë Shoqëria nuk ka krijuar rezervat e parashikuara me ligj ose nga ky Statut.

NENI 16 **Rezervat**

(1) Asambleja e Përgjithshme krijon rezerva sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9901/2008. Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit të Administrimit, mund të krijojë rezerva të posaçme nga fitimet e aktivitetit të Shoqërisë për mbarëvajtjen e aktivitetit të saj.

NENI 17 **Prishja dhe likuidimi**

(1) Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga Ligji nr. 9901/2008. Prishja e Shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi.

(2) Likuidimi i Shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e pjesës përkatëse të Ligjit nr. 9901/2008.

NENI 18 **Emërimi i organeve të para të Shoqërisë**

(1) Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë janë të listuar në Shtojcën II bashkëlidhur këtij Statuti.

(2) Administratori i parë i Shoqërisë përcaktohet në Shtojcën III bashkëlidhur këtij Statuti.

(3) Auditor i parë i Shoqërisë përcaktohet në Shtojcën IV bashkëlidhur këtij Statuti.

(4) Ndryshimet e mëvonshme në përbërjen dhe anëtarët e organeve të Shoqërisë bëhen në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901/2008.

NENI 19 **Dispozita të ndryshme**

(1) Ky dokument, duke përfshirë Shtojcat bashkëngjitur, përbën Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë.

(2) Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 6 (gjashtë) ekzemplarë në gjuhën shqipe dhe në 6 (gjashtë) ekzemplarë gjuhën italiane. Në rast mospërputhjes të mundshme ndërmjet dy versioneve gjuhësore të këtij akti, do të ketë epërsi versioni në gjuhën shqipe.

(3) Ky Statut do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 9901/2008.

THEMELUESIT



Shoëria GENERATE Shpk

Z. Alessandro Griffith Brookles




Z. Pietro Urso

Z. Enid Mero

Andri Cos
Alessandro Griffith Brookles
Pietro Urso
Enid Mero

SHTOJCA I KAPITALI – AKSIONET

Nr.	Emri/Mbimri	Adresa/Selia	Nënshkrimi dhe pagesa				Kontributi	
			Pjesëmarrja	Numri i Aksioneve	Vlera e Nënshkruar ne Leke	Pjesa e paguar Lekë		Pjesa e papaguar në Lekë
1	Shoqëria GENERATE Shpk	Tiranë, Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Brigada VIII, Pallati Nr. 28, Kati 3	40%	140	1.400.000	1.200.000	200.000	Para
2	Z. Alessandro Griffith Brookles	Itali, Biella, Strada Cantone Chiesa 16, 13900	40%	140	1.400.000	1.200.000	200.000	Para
3	Z. Pietro Urso	Itali, Romë, Via Vittoria Colonna 11, 00193	10%	35	350.000	300.000	50.000	Para
4	Z. Enid Mero	Rr. Muhamed Gjolllesha, P. 36, Tirane	10%	35	350.000	300.000	50.000	Para
		Kapitali i Nënshkruar	100%	350	3.500.000	3.000.000	500.000	








SHTOJCA II KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

<i>(Emri/Mbiemri)</i>	<i>(Datëlindja)</i>	<i>(Vendlindja)</i>	<i>(Shtetësia)</i>	<i>(Afati i emërimit)</i>
Helada Papa	15/04/1991	Lushnjë	Shqiptare	Nga 08/11/2018 deri më 08/11/2021
<i>(Lloji i dokumentit)</i>	<i>(Nr. i Dokumentit)</i>	<i>(Adresa)</i>	<i>(Detyra)</i>	
letërnjoftim	027960025	Rr. Abdyl Frashëri, EGT Tower, kati 6, Ap. 16, Tiranë	Kryetar	





<i>(Emri/Mbiemri)</i>	<i>(Datëlindja)</i>	<i>(Vendlindja)</i>	<i>(Shtetësia)</i>	<i>(Afati i Emërimit)</i>
Pietro Urso	22/01/1981	Katania (Itali)	Italiane	Nga 08/11/2018 deri më 08/11/2021
<i>(Lloji i dokumentit)</i>	<i>(Nr. i Dokumentit)</i>	<i>(Adresa)</i>	<i>(Detyra)</i>	
Pasaportë	YA6853407	Itali, Romë, Via Vittoria Colonna 11, 00193	Zëvendës Kryetar	

<i>(Emri/Mbiemri)</i>	<i>(Datëlindja)</i>	<i>(Vendlindja)</i>	<i>(Shtetësia)</i>	<i>(Afati i Emërimit)</i>
Marin Piranjani	11/10/1988	Tiranë	Shqiptare	Nga 08/11/2018 deri më 08/11/2021
<i>(Lloji i dokumentit)</i>	<i>(Nr. i Dokumentit)</i>	<i>(Adresa)</i>	<i>(Detyra)</i>	
letërnjoftim	027176596	Rr. Muhamed Gjolllesha, P. 36, Tirane	Anëtar	

SHTOJCA III ADMINISTRATORËT

<i>(Emri/Mbiemri)</i>	<i>(Datëlindja)</i>	<i>(Vendlindja)</i>	<i>(Shtetësia)</i>	<i>(Afati i Emërimit)</i>
Marin Piranjani	11/10/1988	Tiranë	Shqiptare	Nga 08/11/2018 deri më 08/11/2021
<i>(Lloji i dokumentit)</i>	<i>(Nr. i Dokumentit)</i>	<i>(Ka kufizime në tagrat e përfaqësimit?)</i>		
Letërnjoftim	027176596	Po <input checked="" type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	<i>(Nëse ka kufizime shëno)</i> Neni 12.6 i Statutit
<i>(Adresa)</i>	Rr. Muhamed Gjollësja, P. 36, Tirane			
Administrator				

SHTOJCA IV - AUDITORËT

Ekspert Kontabël i Regjistruar	NUIS	Autoriteti Licencues	Data e Licencës	Numri i Licencës
Gerta Avrami	L51423030F	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë	16/01/2015	348

